

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQERISË TREGËTARE "Linzar 3" SHPK

FORMIMI

Neni 1

Sot me date 20.07.2018 krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Linzar 3" Tiranë me ortakun e saj të vetëm znj. Dorina Bime, lindur në Gjirokastrë më 05.10.1985 dhe me banim në Tiranë, me nr.personal 1560050731; Rruga "Qemal Stafa"

SELIA

Neni 2

"Linzar 3" SHPK Tiranë e ka selinë e saj në Tiranë dhe adresë :

Njësia administrative nr.8, rruga "Qemal Stafa", pallati Fed Invest ,apartamenti 25, Tiranë

Shoqëria tregëtare, personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj, me miratimin e organeve përkatëse dhe sipas legjislacionit e normave të vendit ku do të hapen. Zyrat e përfaqësimit janë vende të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë

KOHË ZGJATJA

Neni 3

Kohë zgjatja e shoqërisë tregëtare është pa afat dhe mund të shpërndalet në cdo kohë me vendim të ortakeve dhe në bazë të kushteve të përcaktuar në statut.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Projektme, studime, zbatime, supervizion e kolaudime në fushën e ndërtimeve civile, industriale, hidroteknike e infrastrukture. Konsulencë, asistencë teknike e logjistike në këto fusha. punime dheu, ndertime civile e ekonomike,ndërtime rrugësh, rikonstruksion godinash, punime karpentierie etj. Studime fisibiliteti në fushën e infrastrukturës. Konsulencë e projektim në fushën e ekologjisë. Përpunimi i plehrave e riciklimi i tyre.

du 18

Import, eksport, tregeti me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm elektrike, hidraulike, ushqimore, përjashtuar karburantë e lubrifikantë.

Gërmim dhe me punime eventuale murature e beton armeprishje në tokë të gërmuar, prodhim materiale inerte-gurë, restaurim i ndërtesave monument kulture, instalimi i impianteve higjenike, kuzhina ,lavanteri, hidrosanitare-mirëmbajtje e tyre, instalimi i materialeve prej druri-metalike plastike-xhami,punime bojatisje-hidroizolim-termoizolim-akustikë-kundra zjarrit etj.

Neni 5

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Linzar 3" mund të ndryshojë emërtimin, vend qendrimin dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të merret nga ortaku/ët e saj .

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindë mijw) lekë i ndarë në 1 kuotw dhe përbëhet nga kontributi i ortakut/ve

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltarë janë të nënshkrueshme dhe të shlyeshme krejtësisht. Çdo pjese i takon e drejta e një vote. Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet me vendimin e asamblesë së ortakëve por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltarë.

Nëpërmjet transferimt të pjesëve të kapitalit të shoqërisë në atë themeltar, bashkëshortët, paraardhësit, pasardhësit mund të bëhen ortakë të shoqërisë. Kapitali mund të lihet i ngrirë si dhe të transferohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe mund të transferohet apo të lihet peng dhe me anë të të drejtës së trashëgimisë.

Neni 7

Shoqëria drejtohet nga ortaku i saj **Znj. Dorina Bime**. Administratori i "Linzar 3" Tiranë do të jenë si më poshtë z. **Tauland Tortja dhe Orgys Demiraj**
Ortakët kanë të drejtë të emerojnë dhe të autorizojë një ose me shumë administratorë. Gjithashtu ortaku kanë të drejtë të marrin vendime për drejtimin e shoqërisë si dhe me ndryshimet e saj. Ata kanë të drejtë të punësojnë punonjësit e shoqërisë dhe me ta janë të detyruar te lidhin kontrata pune sipas legjislacionit shqipëtare.

Neni 8

Shoqëria ka vulën e saj e cila perdoret vetëm nga ortaku/ët e/i saj. Shoqëria fiton personalitet juridikë me rregjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit të Biznesit, si dhe me rregjistrimin në organet e tjera kompetente përkatëse.

Neni 9

Shoqeria në cdo periudhë tremujore apo 6 mujore ka të drejtë të nxjerrë bilancet si dhe ato vjetore .Ortakët e saj do të caktojnë ekspertin kontabël, likujdatorët e shoqërisë.

Kjo shoqëri mund të shperndahet në cdo kohë dhe kur janë kushtet e percaktuara ne statut.

Per sa me siper u lexuan nga ortakët dhe u nënshkrua në bazë të vullnetit të lirë dhe të plotë të tyre.

ORTAKU I "Linzar 3" TIRANË

ZNJ. DORINA BIME





Faint, illegible text or markings in the upper middle section of the page.

Faint, illegible text or markings in the middle section of the page.

Faint, illegible text or markings in the middle section of the page.



Handwritten initials or a signature, possibly "SIB", located in the bottom left corner.

